



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:279905  
Datë: 21.03.2024  
Numri i dokumentit: 05486519

**C – IV. - 15 - 0897**

**Paditësi:**

M J nga fshati S i Komunës së Drenasit në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit .

**Kundër**

**E paditura:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

**Objekti i çështjes :** Kompensimi i pagave të pa paguara dhe kompensimi në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

**Për :** Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.21.03.2024**, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET si e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësit, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit e paraqitur kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe Vendimet e Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, dhe atë : Vendimi, PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe Vendimi, PRN011 - 0270 i dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), **VËRTETOHEN si të drejta dhe të bazuara në ligj.**

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me dt.30.03.2015, paditësi, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit përmes dërgimit me postë, në DhPGJSK, ka parashtruar, ankesë kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe lidhur me Vendimin, PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe Vendimi, PRN011 - 0270 i dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për

kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), e me të cilat Vendimi, paditësit, i janë refuzuar si të pa vlefshme kërkesat e lartëcekura.

Në arsyetimin e Vendimit të tij, PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 €, AL-ja, është bazuar në dispozitën e nenit në bazë të nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034 për AKP-në, , i cili parasheh se : " ... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme", si dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24), parasheh se : "Pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkese tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet", si dhe se në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet se nuk ka përmbushur ndaj parashtruesit, detyrimin e saj i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës e kjo do të thotë, tre vjet nga viti 1990, kur parashtruesi ndërpreu marrëdhënien e punës me NSh-në, dhe për pasojë nuk ka pranuar pagën, si dhe se nuk ka dëshmi se pranë AL-së e cila dëshmon se parashtruesi ka paraqitur këtë kërkesë në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent që nga viti 1990, në mënyrë që të ndërpres periudhën e parashkrimit dhe se për këtë arsye AL-ja, ka ardhur në përfundim se kërkesa e paditësit, është e parashkruar si dhe si të tillë e ka refuzuar si të pa vlefshme e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së.

Po ashtu edhe në Vendimin e tij, PRN011-0270 të dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), AL-ja, ka dhënë arsyetimin e tij duke u bazuar në nenin 40.1.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që parashtruesve, iu takon e drejta për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse : "janë pushuar nga puna si rrjedhojë e apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP-ja, sipas nenit 6.0 apo 6.2", se privatizimi është njëri nga veprimet e AKP-së të parapara në nenin 6.2.1 dhe 6.2.1 dhe likuidimi i paraparë në nenin 6.2.2 të Ligjit për AKP-në, se pas shqyrtimit me kujdes të arkivit të NSh-së, AL-ja, ka zbuluar se në kohën e privatizimit, parashtruesi, nuk ka qenë punëtor aktive i NSh, K.B, "Drenica" (në likuidim) e kështu paditësi, nuk është pushuar nga puna për shkak të privatizimit apo likuidimit të NSh-së por kontrata e tij e punës, është ndërprerë në vitin 1990, pra shumë kohë më parë para se të themeloheshin Agjencia Kosovare e Privatizimit apo para ardhësja e saj, AKM-ja, prandaj parashtruesi, këtu paditësi, nuk gëzon të drejtën për dëmshpërbllim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, prandaj edhe AL-ja, ka ardhur në përfundim se kjo kërkesë, është e pa vlefshme.

Lidhur me kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006, ajo është refuzuar e duke u bazuar po ashtu në nenin 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034 për AKP-në, si dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24), dhe se sipas këtyre dispozitave ligjore, kërkesa e tillë, ishte dashur që të paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet se nuk ka përmbushur ndaj parashtruesit, detyrimin e saj i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës, e cila është 3 vjet nga viti 2000, kur parashtruesi, pretendohet si nuk ka përfituar kompensim, prandaj edhe AL-ja, kishte ardhur në përfundim se kërkesa për pagat është e parashkruar dhe si e tillë edhe e pa vlefshme.

Paditësi në padinë e tij thekson se, në muajin korrik 2014, ka ushtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara nga AKP-ja, brenda afatit ligjor, mbështetur në Ligjin, Nr.04/L- 034 por në përgjigjjen dhe Vendimin e AKP-së, i është refuzuar kërkesa e tij si e pa bazuar, se i lutet Kolegjit për shqyrtimin e ankesave që t'ia pranoj ankesën e tij si të bazuar dhe ligjore duke pasur parasysh me normat e përcaktuara sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke i respektuar standardet ndërkombëtare në tërësi, se sa i përket konstatimit ose supozimit se paditësi, a ishte larguar nga NSh, K.B, "Drenica" nën kushtet të diskriminimit, gjykata mund t'a konstatoj në bazë të provave të paraqitura si fakte relevante se në të vërtetë ngjarja ka ndodhur duke u bazuar në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe se ky fakt është relevant i njohur e duke iu lutur kolegjit për shqyrtimin e ankesave që pas administrimit të provave të ofruara t'a aprovoj ankesën e tij ligjore për pjesëmarrje në pagat e pa paguara nga të ardhurat e NSh, K.B, "Drenica", Drenas e më gjerësisht si në këtë ankesë.

Pala paditëse parashtresën e tij e ka titulluar si "ankesë", mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet "nisja e procedurave" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Padisë/ankesës së tij si prova, paditësi, ia ka bashkangjitur : deklaratën e noterizuar të M D, sekretar i NSh-së, Vendimet e kontestuara të AL-së, Vendimi, PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015, Vendimi, PRN011 - 0270 i dt.19.01.2015, kopjen e certifikatës së martesës të dt.29.01.2014 të lëshuar nga Zyra e Ofiqarisë në Komaran, Ekstraktin e lindjes, E ... të dt.... për S J, Vërtetimin, Nr.86 të dt.13.04.2012 të NSh, K.B, "Drenica" me seli në Glllogovc, epitafin e kolektivit të NSh-së të dt.19 Korrik të vdekjes së I J, deklaratën e noterizuar nën betim të dt.22.05.2015 të 2 (dy) dëshmitarëve, I I nga fshati K i Komunës së Drenasit dhe G S nga fshati F e U e Komunës së Drenasit, Vërtetimin nga arkiva në Vushtrri, nr.27/1949RL/27006 të dt. 22.05.2015, dhe kopjen e ID-së së Sadije Janovës.

Me dt.08.03.2024, e paditura, AKP me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, duke vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0897 të dt.27.02.2024, në këtë gjykatë ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, sa i përket, Vendimit të tij, PRN011 - 0270 të dt.19.01.2015, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme pasi që objekt i kësaj procedure gjyqësore, është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria e me Ligjin, Nr.04/L-034) e Vendimit të AL-së, dhe se në këtë mënyrë është shkelur neni 74.2 i Ligjit, nr.06/L-086, parashikon se ankesa e dorëzuar në DhPGJS kundër Vendimit të AL-së, duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit, nuk është kryer në përputhje me Ligjin, nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, se në bazë të nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034, parashihet se : " ... *elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*", se neni 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24), parasheh se : " *pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet*", e në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga viti 2000 kur NSh-ja, pretendohet se nuk e ka përmbushur ndaj parashtruesit, detyrimin e saj i cili rrjedh nga marrëdhënia e punësimit derisa përket Vendimit, PRN011 - 0269 i dt.09.02.2015, kërkesa do të duhet të ishte e paraqitur në gjykatë apo në ndonjë autoritet tjetër kompetent që nga vitet 1990 për t'a ndërprerë parashkrimin e duke i propozuar gjykatës, që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe t'a vërtetoj Vendimin e

Autoritetit të Likuidimit, në pajtim me nenin 36.2 dhe nenit 74.1 të Ligjit, Nr.06/L – 086 e më gjerësisht si në këtë mbrojtje.

Me dt.11.03.2024, me Urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 0897 të dt.11.03.2024, kjo gjykatë, mbrojtjen e të paditurës, ia ka adresuar paditësit, për të dhënë përgjigje në këtë mbrojtje, dhe atë brenda afatit prej 7 ditëve, dhe se i njëjti me dt.20.03.2024, ka paraqitur parashtrësë e së cilës, ia ka bashkangjitur pothuajse të gjitha provat e deritanishme të bashkangjitura ankesës/padisë së tij dhe provat tjera të cilat janë pjesë e kësaj lënde por edhe provat tjera siç janë, Ekstrakti i vdekjes, V ... i dt.... për I J, një listë të emrave, Shkresën e dt.13.04.20122 të 2 dëshmitarëve të OP, "Drenica" OTHPB, "Agroprodukti" me seli në Gllogovc, dhe kopjen e aktvendimit, T.nr.22/06 të dt.24.08.2006 të Gjykatës Komunale në Gllogovc për trashëgimlënësen, M M J dhe shpalljen e trashëgimtarëve ligjor të saj.

### **Arsyetimi Ligjor**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), parashihet se: *"Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore"* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *"Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit, duhet të refuzohet e pabazuar.

### ***Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.***

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.09.06.2014, ndërsa parashtruesi, në procedurën e likuidimit, tek AL-ja ka parashtruar kërkesën e tij me dt.30.07.2014, e që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në procedurë të likuidimit tek AL-ja dhe se AL-ja, me Vendimet e tij, PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe me Vendimin, PRN011 - 0270 i dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), paditësit, i janë refuzuar si të pa vlefshme kërkesat e lartë cekura ndërsa ankesën pranë DhPGJSK-së, e ka bërë me dt.27.05.2015 (sepse e paditura, nuk e ka kontestuar afatshmërinë e ankesës përmes mbrojtjes së dhënë në padinë e paditësit), dhe konsiderohet se këtë ankesë kundër këtyre 2 (dy ) vendimeve) e ka bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të këtyre Vendimet e kontestuar të AL-së, dhe se të njëjtës

ankesë/kërkesë/padi, ia ka bashkangjitur, Vendimeve të kontestuar të AL-së. PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015 dhe PRN011 - 0270 i dt.19.01.2015. Andaj gjykata, vlerëson se ankesa/padia e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë në aspektin procedural sipas dispozitave ligjore nga neni 36 dhe 74 Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

***Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.***

Gjykata gjen se nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse, ka qëndruar raporti juridik i marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas, e të cilën tani e përfaqëson AKP-ja, për të cilën i njëjti fakt nuk kontestohet nga palët ndërgjyqëse, por kontestuese mes palëve, është se për Vendimin e AL-së, PRN011 - 0269 të dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 €, kërkesa e paditësit, a është paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor prej 3 (tre) viteve në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet se nuk ka përmbushur ndaj parashtruesit, detyrimin e saj i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës e kjo do të thotë, tre vjet nga viti 1990 derisa për Vendimin e AL-së, PRN011 - 0270 të dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), se në kohën e privatizimit, parashtruesi, nuk ka qenë punëtor aktive i NSh, K.B, "Drenica" (në likuidim) e kështu paditësi, a është pushuar nga puna për shkak të privatizimit apo likuidimit të NSh-së apo kontrata e tij e punës, i ishte ndërprerë në vitin 1990, pra shumë kohë më parë, para se të themeloheshin Agjencia Kosovare e Privatizimit apo para ardhësja e saj, AKM-ja, e veçmas kontestues, na paraqitet edhe fakti se M J nga fshati S i Komunës së Drenasit, a ka të drejtë që të kërkojë në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit, kompensimin e kërkesave të përshkruara më lartë dhe atë për shkak të faktit të vdekjes së Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit, ish i punësuar i NSh, K.B, "Drenica" me seli në Drenas.

Gjykata gjen se parashtruesi edhe me rastin e parashtrimit të ankesës//padisë kundër Vendimeve të kundërshtuara të AL-së, nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo provë me të cilën gjykata mund të vendoste ndryshe nga AL-ja me rastin e refuzimit të kërkesave të tij si të pa vlefshme në procedurën e likuidimit, andaj AL-ja me rastin e shqyrtimit të kërkesave së paditësit, ka vërejtur se kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet se nuk ka përmbushur ndaj parashtruesit, detyrimin e saj i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës e kjo do të thotë, tre vjet nga viti 1990, kur parashtruesi ndërpreu marrëdhënien e punës me NSh-në, pra lidhur me Vendimin e AL-së, PRN011 - 0269 të dt.08.02.2015 që ka të bëjë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 €, derisa për Vendimin e AL-së, PRN011 - 0270 të dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), është provuar se në kohën e privatizimit, parashtruesi, nuk ka qenë punëtor aktive i NSh, K.B, "Drenica" (në likuidim) e kështu paditësi, nuk është pushuar nga puna për shkak të privatizimit apo likuidimit të NSh-së por kontrata e tij e punës, është ndërprerë në vitin 1990, pra shumë kohë më parë para se të themeloheshin Agjencia Kosovare e Privatizimit apo para ardhësja e saj, AKM-ja, prandaj parashtruesi, këtu paditësi, nuk gëzon të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme e për tepër, me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, paditësi, nuk pushuar nga puna si rrjedhojë e apo në lidhje me veprimin e

ndërmarrë nga AKP-ja, siç parashikohet në nenet 6.1 dhe 6.2 të Ligjit për AKP-në, andaj me të drejtë AL-ja, edhe ia ka refuzuar si të papabuzuar kërkesën e parashtruesit, këtu paditësit.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se : *''Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. ....''* .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesat e paditësit, kanë të bëjë me kërkesat preferenciale të parapara në nenin 40 par.1 pika 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në gjegjësisht për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e që ka të bëjë me Prioritetin e kërkesave dhe interesave, e në të cilin parashihet se : *''Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim:... kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim: ... kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në''* por edhe me kërkesat e pa siguruara e të parapara si lloj i kërkesave, në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *''Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''*

Në nenin 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034, parashihet se : *'' ... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme''* derisa në nenin 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *''Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet''* e për më tepër edhe në nenin 77 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Përkitazi me çështjen e vdekjes së një pale, si në rastin konkret, në nenin 359 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr.GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978), parashihet se: *''Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit pushon detyrimi vetëm në qoftë se ka lindur duke marrë parasysh veçoritë personale të njerës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit''* ndërsa edhe në nenin 340 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr. 04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për vdekjen e një pale, aty thuhet se : *''Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njerës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit''*. Duke qenë se Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit, kishte vdekur edhe para se të bëhej në emër të tij kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara si dhe për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në procedurën e likuidimit pranë AL-së, dhe të ciliën e ka bërë, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit, pas vdekjes së këtij të punësuarit në këtë NSh, por edhe pse parashtruesi, këtu paditësi, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit, ankesës /padi së të tij, ia ka bashkangjitur disa prova rreth pretendimeve të tij prapë se prapë këto prova nuk kanë ndikim në bazueshmërinë e pretendimit të tij për kërkesat e trajtuara nga AL-ja, me Vendimin e tij, PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe me Vendimin, PRN011 – 0270 i dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara

për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K,B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim) sepse ish i punësuari në këtë NSh, pra Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit, ka vdekur, tek me dt... në Prishtinë, dhe se kërkesat e natyrës së tillë juridike, nuk mund të jenë të bartshme tek trashëgimtarët e tij, tani i ndjerë sepse të njëjtat kërkesa lidhen veçorinë personale të paditësit dhe aftësitë personale të tij, e në shkresa të lëndës, nuk ka ndonjë vendim të plotëfuqishëm të gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent që para vdekjes, paditësit, t'i jenë njohur këto kërkesa, andaj, gjykata vije në përfundim se, kërkesëpadia e paditësit, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit, e bërë në emër të ish të punësuarit, Y J nga fshati Sankovc i Komunës së Drenasit, është e pabazuar. Andaj gjykata me arsyet e cekura më lartë, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, padinë/ankesën e paditësit të ushtruar kundër Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe atë Vendimit, PRN011 - 0269 të dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe me Vendimin, PRN011 - 0270 të dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K,B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), duhet t'a refuzojë si të pabazuar.për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe me Vendimin, për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K,B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), duhet t'a refuzoj si të pabazuar në ligj.

### ***Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës***

Gjykata vlerëson se, pas administrimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e pas konstatimit të gjendjes faktike, ka ardhur në përfundim, se qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimet e Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN011 - 0269 i dt.08.02.2015, ku e ka bërë refuzimin e kërkesës së parashtruesit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe Vendimi, PRN011 - 0270 i dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K,B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), është i drejtë, duke vlerësuar si të pavlefshme kërkesat e parashtruesit e duke u bazuar në 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034, dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, se kërkesa e tij për pagat e pa paguara, janë të parashkruara sepse paditësi, nuk ka ofruar prova se para dt.30 korrik 2014, kërkesën e tij për kompensimin e këtyre kërkesave, t'a ketë bërë - paraqitur në gjyq apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra tre vite nga koha kur parashtruesi nuk ka përfituar nga ndërmarrja e pretenduara, në rastin në fjalë më së voni tre vite nga viti 1990 gjegjësisht 2000 kur NSh-ja, pretendohet se nuk e ka përmbushur ndaj parashtruesit, detyrimin e saj i cili rrjedh nga marrëdhënia e punësimit derisa kërkesa për dëmshpërbllimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënie së punës, është e pa bazuar edhe për faktin se paditësi, nuk është pushuar nga puna për shkak të privatizimit apo likuidimit të NSh-së por kontrata e tij e punës, është ndërprerë në vitin 1990, pra shumë kohë më parë para se të themeloheshin Agjencia Kosovare e Privatizimit apo para ardhësja e saj, AKM-ja, prandaj parashtruesi, këtu paditësi, nuk gëzon të drejtën për dëmshpërbllim për ndërprerje të parakohshme e për tepër, me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, paditësi, si rrjedhojë marrëdhënia e tij punës, nuk i është ndërprerë si rezultat i një veprimi të Agjencisë të parapara me nenin 6.2.1 apo 6.2.2 dhe se në veprimet e AL-së, nuk ka veprime ndaj parashtruesit me të cilën mund të realizonte të drejta në pretendimet e tij, dhe si rrjedhojë nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga agjencia siç parashikohet

në nenet 6.1 dhe 6.2 të Ligjit për AKP-në si dhe se në kuptim të nenit 359 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr.GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 dhe nenit 340 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr. 04/L-077 të dt.10 maj 2012, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit, nuk mund të kërkoj kompensimet në fjalë për Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit meqë i njëjti ka vdekur që me dt.18.07.1994 në Prishtinë, dhe kërkesat e natyrës së tillë juridike, nuk mund të jenë të bartshme tek trashëgimtarët e një të punësuarit tek një NSh, e në rastin konkret tek Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), tani i ndjerë sepse të njëjtat kërkesa lidhen *veçoritë personale të paditësit dhe aftësitë personale të tij*, e në shkresa të lëndës, nuk ka ndonjë vendim të plotëfuqishëm të gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent që para vdekjes, paditësit, t'i jenë njohur këto kërkesa, andaj, gjykata vije në përfundim se, kërkesëpadia e paditësit, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit, është e pabazuar. Andaj si rezultat i qëndrimeve dhe arsyeve të cekura më lartë, rrjedh përfundimi se kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditësit, M J nga fshati S i Komunës së Drenasit në emër të Y J nga fshati S i Komunës së Drenasit e paraqitur kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe Vendimet e Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, dhe atë lidhur me Vendimin, PRN011 – 026 9 të dt.08.02.2015 për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 1990 deri më 1994 në shumën prej 7,680.00 € dhe Vendimin, PRN011 - 0270 e dt.19.01.2015 për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2000 deri më 04 Nëntor 2006 në shumën prej 10,080.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), K.B, "Drenica" me seli në Drenas (në likuidim), e refuzoj si të pa bazuar, dhe Vendimet e kundërshtuara të AL-së, i vërtetoj si të drejta dhe të bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore për vendim marrje.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) dhe Udhëzimit Administrativ, Nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij Udhëzimi, gjykata vendosi që secila palë t'ia bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS** **2022:279905, 21.03.2024**

**Gjykatësi,**  
**Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).